



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-16299-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date 18-06-2025
OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.30.05.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Florije Jashari (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiçi Kabashi, (IQO), Jeton Mjekiçi (IQO), Nazlije Shala, (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Valon Svirca (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Albana Shillova Shalaku (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Bajram Hashani (LDK), Linda Sadiku Krasniqi, (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, Ibadete Hasani, zyrtare e lartë ligjore, përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiçi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloimbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DPUKP-së, nr.05-104-02-12876-25, të dt.14.05.2025 - Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës nr.02-020-01-12881-25, i dt.14.05.2025, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Plemetin
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës nr.-I-713/25, të dt.13.05.2025 për subvencionimin e N.P.L "Kastritoti" SH.A.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.02-020-01-13006-25, të dt.15.05.2025 për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesi - I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 17 vota për dhe 3 vota abstenim.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Fidan Ahmeti

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesja - Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DPUKP-së, nr.05-104-02-12876, të dt.14.05.2025, Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020-01-12881-25, i dt.14.05.2025, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Plemetin.

Enver Gasni – Ne si grup parlamentar jemi për shpronësimin e kësaj parcele, pasi që është në interes të lagjes "Bregaj" në fshatin Plemetin, që i ka paraprirë edhe peticioni, kështu që jemi për.

Kryesuesja – Ne e kemi edhe propozim vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm publik në zonën kadastrale.

Sami Ahmeti – Në parim në gjithmonë jemi që komuniteteve, të iu ndërtohen objekte që janë në shfrytëzim të tyre. Kur bëhet fjalë për kërkesën aktuale që sot këtu e kemi kjo, jo vetëm që është e dyshimtë por mendoj se ka arsye me dërgue direkt në polici, pasi që ta kryejmë këtë seancë. Në 1 peticioni nuk i plotëson kriteret, peticioni nuk shkruan asgjë, janë mbledhë disa emra për të cilin do të kthehem përsëri. Në 2 kërkesën e ka bërë pronari i tokës që po don me iu shpronësue gjegjësisht djali i tij. Berati është djali i Asllanit e Asllani është pronari i tokës. Askund qytetarët nuk thonë që kërkohet kjo pronë, por vetë Berat Asllan Mehmeti, që ka bërë kërkesë për pronën e vetë personale. Më poshtë e ka bashkangjitur një peticion, që të paktën një person është i vdekur për atë peticion që ka nënshkruar dhe për këtë thashë që do të lajmërohem direkt në polici. Ju lus të gjithëve që keni guximin votone, veç ta dini se secili që e bën këtë votim është vepër penale. Ne jemi që komuniteteve të iu sigurohet hapësira për çkadoqoftë, por jo duke keqpërdorë paratë publike sepse kërkesa që vjen edhe propozim vendimi nuk ka asnjë arsytim cilat janë shpenzimet e paratë publike që merret kjo pronë. Me një fjalë unë ju lus që ti thirrni mendjes, mirëpo secili prej juve lirisht votone që doni, por në momentin që kryhet kjo seancë unë do të shkoj në polici sepse është keqpërdorë dhe është bërë falsifikim i nënshkrimeve dhe janë vendosë persona që janë të vdekur tashmë.

Ajet Berisha – Parafolësi e tha pjesën më të madhe të atyre që kisha me thënë edhe unë. E para, mendoj se proceduralisht është gabim e shtruar për këtë Kuvend sepse kërkesën për një gjë të tillë është dashtë me bë Kryetari i Komunës, e jo Berat Mehmeti. Mund të ndodhë që me të drejtë mund me u shpronësue ajo pronë ajo pjesë, që po kërkon fshati, por kërkesën për këtë interes publik nuk është dashtë me na ardhë prej Berat Mehmetit si pronar i parcelës, por prej Kryetarit dhe marrëveshjes me lagjen. Do të thotë inicimi është prej Berat Mehmetit, thotë u takova me lagjen jemi të interesuar me na bë një fushë sporti dhe objektin aty për të pame, hajde blene tokën time. Është njëfarë lloj konflikti pa hy në nënshkrime, që absolutisht nuk i kam analizue edhe pse nuk ka në parashitje për çka kanë nënshkruar ata qytetarë, kështu që kurgjë nuk ka të shenuar lartë. Unë të lus kryesuese që këtë pikë ne si Kuvend ta anulojmë dhe në rast se ka diçka që duhet është dashtë Kryetari në mënyrë procedurale me i shkue në mënyrë të rregulltë kësaj pune dhe jo në këtë formë sepse unë për vete jo që nuk e votoj, por ju lus edhe juve që me anulue dhe me heqë krejtë prej rendit të ditës.

Arben Berisha – Ne si Drejtori kemi mbajtur takim me banorë dhe unë personalisht nuk kam qenë atje, por stafi ynë ka qenë edhe e kanë marrë kërkesën e tyre si kërkesë normale. Po ashtu, e kemi trajtue këtë kërkesë aq sa neve, na është dhënë mundësia si Drejtori. Të gjithë banorët njëzërit kanë qenë për parcelën në fjalë për arsye se parcela është sa më afër komunitetit dhe i shërben komunitetit. Propozim vendimi është prej Kryetarit, e jo prej banorëve që besoj se edhe juve iu ka ardhë me material.

Kryesuesja – Sa për korrektësi drejtor, është edhe kërkesa nga ju dhe propozim vendimi, do të thotë është komplet lënda.

Arben Berisha – E kemi edhe një dokument që ka ardhë prej meje si drejtor kam bërë kërkesë te ju për me përfshi në rend dite për shqyrtim në Komitetin për Politikë dhe Financa, pastaj në Kuvendin Komunal. Sa i përket çështjes së dyshimtë z.Sami i ke dërgue afër 50-60 kërkesa, kështu që e juaja është për me dërgue në organet kompetente, ndërsa e jona është me veprue sipas ligjit. Nëse, këta kanë bërë ndonjë falsifikim të nënshkrimeve, ne nuk e marrim përsipër sepse nuk jemi në hetues dhe nëse është i dyshimtë ndonjë që unë për vete nuk e kam hasë betohem se edhe unë e kisha ngritur këtë çështje dhe kisha me thënë se nënshkrimin e të vdekurit këtu e kanë përfshi. Tash, pse ka ardhë në emër të djalit me shpronësue me keqpërdorë paratë publike prapë fati ynë është që në këtë drejtim çështjen e vlerësimit të pronës e bën Ministria e financave, e jo ne. Ai ka të drejtë të merret me Gjykatë lidhur me çështjen e vlerësimit të financave, por prapa nuk mundet me kthye më sepse ne po e shpallim zonë me interes të përgjithshëm.

Ajet Berisha – E para, e paraqet konfliktin e parë në raport me bindjen time që kjo punë nuk është në rregullë. Do të thotë Berat Mehmeti bën kërkesë thotë se po e organizojmë në lagjen aty, hajde bleje tokën

time dhe ndërto këtë që proceduralisht kjo menjëherë është pengesa. Këtë, është dashtë me trajtue Komuna me lagjen dhe në rast se një parcelë është e përshtatshme me marrë pëlqim sepse ju nuk keni marrë pëlqim prej Beratit e Asllanit, që me shpallë zonë të interesit të veçantë. Unë nuk po shohë pëlqim, ky ka kërkesë e jo pëlqim dhe mendoj se Asllani është dashtë me dhënë pëlqim se ne jemi të gatshëm me hy në një aranzhim të tillë që me u shpallë zonë e interesit të veçantë për juve, që në të ardhmen le të caktohet çmimi unë pranoj. Ti nuk ke pëlqim prej Asllanit, babait të Beratit që kjo punë me u bë, këtu së paku të prezentuar nuk e kemi. E kemi kërkesën prej Beratit, i kemi 2 rreshta prej lagjes që thotë na ndërtoni një fushë që secila lagje thotë dhe një shtëpi për të pame si dhe i kemi nënshkrimet që nuk kanë asnjë mbishkrim lartë. Do të thotë proceduralisht, teknikisht për mua kjo lëndë ka probleme për me u trajtue në Kuvend.

Arben Berisha – Ligji për shpronësimin e pronave e thotë decedivisht nuk mund të bëhet me kërkesën e dikujt, por me interesin e Komunës. Ne e kemi datën për takimin që e kemi pasë me banorë në shkollën e Plemetit me lagjen Bregaj, që mund të ua sjellim edhe juve.

Ajet Berisha – Është shkelje direkte e të drejtave të pronës dhe njerëzore nëse, lagjja thotë kjo tokë e filanit po më konvenon dhe po ia marrim, ndërsa ne hajde e shpallim zonë me interes të veçantë që nuk mundemi hiç drejtor.

Arben Berisha – Në këtë pjesëmarrje, ne të gjithë e dijmë se ata gati të gjithë janë një familje, por tash edhe shkresa e tij e dokumenton se nuk është kundër sepse ai me qenë kundër nuk e kishte bërë.

Labinot Mirena – Pyeti a ka Kryetar të Këshillit të fshatit në Plemetin, pse nuk e ka bërë Kryetari i Këshillit të fshatit, por e ka bërë personalisht djali i pronarit. Kryetari i fshatit është për gjithë fshatin, e jo për një lagje të caktuar, për atë është zgjedhë dhe sa e di unë edhe paguhet prej Komunës. Ai duhet me bë sepse i përfaqëson të gjithë qytetarët aty, e jo lagjja secila veç e veç se me qenë ashtu nuk kishim me shkue në zgjedhje ne hiç.

Shqip Paloja – Pyeti a është vërtetue se nuk ka pronë publike në atë lagje aty, për me shfrytëzue.

Arben Berisha – Përgjegjet se ne kemi hulumtue a kemi prona të Komunës aty, në lagje nuk kemi, në afërsi nuk kemi dhe tash ka dalë si kërkesë e banorëve që janë të nënshkruar me peticion, që me marrë filan pronën. Neve, na konvenon aty që është ajo pronë dhe tash pëlqimi apo mospëlqimi i tij, kjo tash ka tjetër karakter. Po ashtu, çështja e falsifikimit ka tjetër karakter dhe propozim vendimi është prej Kryetarit, kërkesë kemi bë me përfshi në rend dite, kështu që ligjërisht jemi në rregullë ndërsa vendimi është i juaji. Ju mund të merrni vendim, ose me lënë hapësirë deri në seancën e radhës që ne me ju sjellë dokumentacion shtesë çka po kërkon për me vërtetue çështjen se çka fshehet, kush e ka bërë, ose kujt po i konvenon. Edhe takimin me banorët e kemi bërë në shkollë të Plemetit.

Sami Ahmeti – Në lidhje me debatin publik a mundemi me pa dikund ku është thirrë ai debat publik, a ka ndonjë shkresë dikund zyrtare që është thirrë ai debat publik me këtë temë. Mua, më duket se inicimi nuk është prej Komunës dhe tash ne thamë këtu, nëse ndalet unë kam me veprue sepse e ndjej si qytetarë obligim me i krye punët e mia që mi ka dhënë edhe qytetari, por në të njejtën kohë edhe si qytetarë me krye këtë punë. Inicimi po duket se është prej personit dhe në këtë rast prej vetë pronarit, aq më tepër ai është duke e keqpërdorë edhe babën e vetë sepse ai po flet në emër të babës dhe ti e din shumë mirë se për pronën mundet me folë vetëm personi. Po duket pak e aranzhume pa keqkuptime edhe prej juve, po duket kështu e aranzhume sepse jorastësisht nuk është që ti nuk din qysh bëhen këto kërkesa, qysh vjen deri te propozim vendimi, qysh bëhet peticioni. Lëshou më poshtë shikoje peticionin i cili është sikur me i marrë disa letra dikush në rrugë ka nënshkrue dhe vetëm ia ke bashkangjitur lëndës. Edhe ti Vlora, është mirë me pasë kujdes në këto sepse në fund të gjithë kemi me dhënë përgjegjësi mos të iu ofrohet asambleistëve diçka çkado. Pajtohem plotësisht dhe jam krejtë në rregullë me qytetarin z.Berat Mehmet këtij që po i lakohet emri që ndoshta është fajtori më i vogël. Ai don atë pronë të vetën me shpronësue, me përfitue që krejtë është në rregullë, aq më tepër mund të jetë që ajo pronë është kyqe edhe iu ndihmon edhe qytetarëve, por jo duke e keqpërdorë dhe duke u mundue me njollosë kontributin tonë në Kuvend. Unë vetë jam në KPF që kam thënë jemi pro që ta diskutojmë këtë temë. Gjatë shqyrtimit të materialit po delë se ka shkelje që kanë pasojat. Kjo, kështu dhe ashtu nëse, ekzistojnë institucionet MAPL-ja, me institucionet që e

përcjellin këtë ka me ta kthye prapësht sepse është konflikt interesi numër një, kurgjë tjetër është konflikt interesi e mos të flasim për personin që ka vdekë qe 2 vjet dhe ka nënshkrue aty. E për këtë personin unë tash menjëherë do të ndalem te policia sepse nuk dua të flas me tension, pa keqkuptime kur bëhet një peticion në gjendje normale numrat e letërnjoftimeve kontrollohen se a ka bërë peticion, mos ky qytetarë është i Vushtrrisë dhe me numër të letërnjoftimit ke mund me vërejtë se ai person është i vdekur, që janë dy por një është i sigurtë.

Kryesuesja— Unë dua të bëjë një replikë sepse mu drejtuat në radhë të parë me emër. Unë jam kryesuese ligjërish e kam obligim çkado që të më vjen me kërkesë në mënyrë të rregulltë nga Kryetari dhe nga Drejtoritë me paraqitë te ju në Kuvend. Ju, pastaj vetë e pranuat se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e keni shqyrtue dhe keni qenë për me dërgue në Kuvendin Komunal. Ju jeni ata të cilët dëshironi me shtye, me votue, apo çka doni me bë.

Arben Berisha – Edhe një herë po e sqaroj dhe e mbyllim si temë dhe pastaj mbetet vendimi juaj. Për qe e di qysh bëhet e di se me këtë punë jam qe 12 vite dhe këtu, asnjë shkronjë nuk e kam shkruar sepse nuk kam nevojë të thirrem në emrin e askujt. Për atë që thua e ndali, nuk e ndali me më dëgjue mua nuk e kisha ndalë, ai që e ka bërë e merrë përsipër. Unë nuk mbledhi nënshkrime të njerëzve të vdekur sepse nuk më vyejnë asgjë se nuk jam duke e bërë unë për vete aty. Mirëpo, jo MAPL-ja por nuk mundet me kthye askush sepse fundi i fundit organi kompetentë jeni ju ata që e bëni, ose nuk e bëni. Ne tubimin me qytetarë e kemi bërë dhe do të ua sjellim, edhe me foto e kemi bërë, e kam dërguar z.Edin Hashani sepse vetë nuk kam qenë. E kemi edhe procesverbalin që është mbajtur ai tubim me qytetarë. Nëse, doni këtë pikë shtyne për seancën e radhës, në mënyrë që ne të ua sjellim çka po kërkon vetëm se të dini çka po kërkon. Thoni se ka keqpërdorime, por unë nuk e kisha ndalë e kisha dërgue dhe a mundemi me verifikue unë s'jam organ hetues që e verifikoj çështjen e letërnjoftimit se a është z.Sami, apo i Arben Berishës, nuk e bëjë dhe nuk jam ai që duhet me bë.

Enver Gashi – Faleminderit drejtor, që na shpjegove më hollësisht lëndën. Mendoj se kërkesat që janë për verifikimin e mbledhjeve, të takimeve me banorë janë të arsyeshme. Sa i përket pëlqimit direkt të pronarit Asllan Mehmeti, duhet drejtor të na sjellni materialin që është mbajtur takimi, por edhe pëlqimin e drejtëpërdrejtë të pronarit të tokës. Pasi që e shohë disponimin për me shtye këtë pikë të rendit të ditës, e shtyejmë për mbledhjen e ardhshme. Ata janë moti aty pa tokë, pa shtëpi për të pame, pa objekte kreative e sportive edhe një muaj le të presin. Unë z.Sami edhe para një muaji i thashë jo që të ndalë dikush me verifikue, por e ke edhe obligim o kolegu im. Aty, ku dyshon na ndihmon si Kuvend si shoqëri, si qytetarë me i largue të këqijat dhe obligim e kemi, por veç me thënë nuk është mirë.

Labint Mirena – Dua të ndërlihem te peticioni është mirë kolegu Sami nëse, vërtetohet se ka njerëz që nënshkrimet e tyre janë në peticion e kanë ndërrue jetë qe 2,3 vjet dhe kjo nëse, shtyhet është mirë me dërgue në polici sepse nuk është mirë ne si Kuvend me ra në lajthitje karshi qytetarit. Kjo, le të mbetet si vetëdijësim në të ardhmen për të tjerët sepse unë si përfaqësues që jam këtu, nuk mundem me ditë se kush është në atë letërnjoftim, a është dikush nga kjo apo tjetër Komunë. Nëse, bëjnë ata shkelje i marrin përgjegjësitë pastaj, tjerët nuk i bëjnë shkeljet që i kanë bërë këta më përpara.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për dhe 1 votë abstenim e prolonguan për mbledhjen e radhës, apo pas 2 muajve shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DPUKP-së, nr.05-104-02-12876,të dt.14.05.2025, Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020-01-12881-25, i dt.14.05.2025, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale në zonën kadastrale në Plemetin.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nr.-I-713/25, të dt.13.05.2025 për subvencionimin e N.P.L. "Kastrioti" SH.A.

Naim Miftari – Fillimisht dua ta falenderoj N.P.L. "Kastrioti" për angazhimin dhe punën që është duke e bërë sepse falë angazhimit të tyre ne sot e kemi një ambient më të mirë që na shërben të gjithë neve. Kërkesa nga N.P.L. "Kastrioti" është për blerjen e pajisjeve të reja sepse veglat e punës kanë filluar të

amortizohen dhe kompania ka nevojë për blerjen e veglave të reja. Unë i lus të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta mbështesin këtë kërkesë.

Sami Ahmeti – Veglat e reja kanë emra, cilat janë ato çfarë vegla nevojiten, pse nevojiten sepse në raportin paraprak që e morëm para 10 dite, aty na doli që ju keni bërë punë shumë të mëdha, shumë të mira, nuk keni asnjë pengesë. Është shumë me rëndësi me u cekë saktë cilat janë veglat dhe pas fjalës së z.Naim me na tregue edhe Ekzekutivi se çka mundemi ne me bë për këtë punë, prej cilës vijë buxhetore mund të suportohet kjo kompani. Pastaj, pse në kërkesë nuk vijnë kërkesat për rritje të pagave të punëtorëve, që i kemi me paga katastrofike, por po flasim për disa mjete që ndoshta mundemi me shtye ende me ato. Kushtet e punës, po vetëm se ne po vazhdojmë me qenë vetëm brenda Komunës tonë. Edhe në raportin paraprak ne e cekëm pse kjo kompani nuk po mundet me dalë jashtë Komunës me marrë punë dhe me mirëmbajtje veten më mirë, por po vazhdon me marrë prej xhepit të vetë sepse Komuna, ose Kuvendi është aksionar i 100 % i saj.

Ajet Berisha – Unë edhe në mbledhjen e kaluar kur diskutuam rreth raportit të punës të kësaj kompanie, i ngrita disa shqetësime të mia që kanë të bëjnë fillimisht rreth organizimit të kompanisë, që thashë zyrtarë të burimeve njerëzore 2, njësia e recepcionit 8, fotograf 1, zyrtar për informim dhe marketing 1. Do të thotë a është mirë e organizuar kompania sepse për me kërkuar mjete shtesë duhet njëfarë lloj strukturimi që bazohet mbi baza ligjore dhe funksionale, e jo ti ngarko kompaninë me njerëz të panevojshëm që nuk i kryejnë punë kompanisë. Pastaj, mjetet të cilat i kushtojnë kompanisë edhe për paga edhe për elemente tjera, dhe thua më jepë mjete shtesë se më vyen për me ble pajisje, e para. E dyta, mendoj se para se me marrë këtë vendim ky Kuvend, është dashtë minimalisht me pasë një raport të auditit për këtë kompani që me i ditë rekomandimet që i ka dhënë auditori, me ditë mirë funksionimin sepse normalisht secila organizatë në raportim i bën raportet e punës dhe e lavdëron vetveten. Mirëpo, një auditor i jashtëm qoftë edhe i brendshëm se kam parë që ka Komitetet dhe audit në kompani me pasë minimalisht një raport të tyre që me u bazue, cilat kanë qenë rekomandimet, qysh janë sjellë në raport me ligjin, me pagat, prokurimin, me punëtorin, me pajisjet. Të gjitha këto kanë rëndësi që ne me i ditë. Është dashtë secili dokument që është bërë për këtë organizatë me ardhë dhe me u shqyrtue sepse minimalisht ne si Kuvend këto nuk i kemi. Edhe një element tjetër i rëndësishëm duke qenë i lidhur direkt me QKMF-në dhe institucionet tjera, unë e shohë që kjo kompani ka marrë tender furnizim me material për sanimin e dëmeve brenda objekteve komunale në Komunën e Obiliqit. Minimalisht 4,5 herë e di një kërkesë që ia kemi bërë kësaj kompanie dhe këtë po e bëjë për me bë një lloj komunikimi më zyrtar dhe më korrekt si dhe me pasë parasysh kjo kompani sepse 30,000 euro, ka marrë tender për këtë punë që kur QKMF-ja, Drejtoria e shëndetësisë, drejtori i shëndetësisë bën një kërkesë në raport me problemet në QKMF, dije se aty është shumë sensitive. Aty, është shumë e ndijshme edhe nëse është puna vetëm për një lavabo, për një ventil, për ujë të ngrohtë aty është e ndijshme, aty ka infeksione sepse është vend ku qarkullojnë të sëmurët me sëmundje të ndryshme. Nuk mundesh 5 herë me i bë kërkesë kësaj kompanie që është përgjegjëse me rregullue një ventil në fshatin Breznicë për ujë të ngrohtë dhe nuk shkon. Do të thotë është punë e ndërtimit të raportit zyrtar kur drejtori i QKMF-së, kur Drejtoria e shëndetësisë bën kërkesë, ndryshe është në një toalet me u prish një ventil edhe pse është shumë e ndijshme. Ndryshe është në ambullantë në 3 dhoma të QMF-së, në Breznicë për shkak të një ventili nuk ka ujë të ngrohtë. Edhe kemi bë kërkesë zyrtarisht së paku me përgjegjësin brenda QKMF-së, kam thënë se nuk kanë ujë të ngrohtë, aty duhet me u dezinfektue dhe patjetër aty duhet uji i ngrohtë. Mbi bazat e kësaj po kërkoj një raport zyrtar në kuptimin e komunikimit në mes të sektoreve në kuadrin e Komunës, duhet me u bë me shkrim përmes emailave me u argumentue që kërkesës kjo kompani i përgjegjëset në mënyrë të shpejtë minimalisht në mjekësi sepse është shumë sensitive dhe ka peshë shumë të rëndë që mundet me bartë pasoja për mosveprim. Unë nuk jam kundër këtyre mjeteve, por së paku pa e pasë një auditim nuk votoj për edhe pse e di që ka nevojë me pa si po shkon mirëmbajtja e këtyre pajisjeve fillimisht që i kanë është shumë me rëndësi sepse ne nuk kemi fuqi shumë të madhe si Komunë. Neve, na ka mbetë QKMF-ja, dijeni. Do të thotë kemi punuar pa standard dhe tash me intervenimin e kësaj kompanie u rregullue diçka, por aty ka mbetë shumë keq. Për momentin kjo kërkesë

për mua është lluks dhe unë nuk e di a keni bërë marrëveshje, a ia keni dhënë mjetet kompanisë që ka me ndërtue. Ato mjete nuk janë bartë deri në muajin e kaluar dhe ata nuk po punojnë sepse Komuna nga bashkëfinancimi nuk e ka krye obligimin e vetë.

Shaip Paloja – Unë si anëtar i Komisionit të aksionarëve, ju njoftoj se para një kohe është ndryshue Statuti i Ndërmarrjes dhe aty janë shtuar disa aktivitete tjera, aktivitete me të cilat nuk kanë operue deri tash. Kjo, është një arsye që përmes këtyre aktiviteteve janë marrë për bazë që hyjnë në funksion edhe të komunitetit në Komunën tonë dhe jashtë Komunës dhe shumë shpresoj se aty do të gjenerohen edhe mjete në të ardhmen. Prandaj, në ato aktivitete kërkohen mjete shtesë tjera, që iu duhen për punë Ndërmarrjes. Këto, që i kanë kërkue mendoj se nuk mjaftojnë dhe e kisha ftue Kuvendin që patjetër të votoj subvencionimin e Ndërmarrjes sepse janë duke e bërë një punë të shkëlqyeshme.

Enver Gashi – Shumicën e fjalëve veç mi mori kolegu im z.Shaip dhe kryesuesë të lutem mos ti lejojmë anëtarët e Kuvendit të zbrazen për të gjitha problematikat që i kanë ose i kanë parë apo mendojnë që janë, por të fokusohemi më shumë në rend dite, ti përmbahemi minotazhës që na e lejon Rregullorja dhe ligji, kështu që edhe Kuvendi do të jetë më efektiv. Sa i përket temës së caktuar ne jemi për që të ndahen mjetet e kërkuara nga N.P.L “Kastrioti”. E përmendi edhe parafolësi se këto mjete janë minimale, mirëpo shpresojmë dhe besojmë shumë se në të ardhmen nuk kanë me kërkue, por me dhënë mjete te arka e Komunës.

Kryesuesja – Kërkoj nga drejtori Naim dhe drejtoresha e financave të përgjegjen se nga merren mjetet dhe a ka mjete të mjaftueshme.

Naim Miftari –Mua, nuk më çudit diskutimi i z.Sami se nuk e foli asnjë fjalë të vetme të mirë për punën që është duke e bërë Ndërmarrja, por po e shohë se suksesi i Ndërmarrjes këtij po i pengon. Në pyetjen që e bëri po përgjegjem konkretisht se me këto mjete pritet të blehen kosa trimera, motor sharra, traktorë dhe bagerë varësisht prej çmimit të tregut duhet të bëhet edhe klasifikimi i blerjes së këtyre pajisjeve.

Zarife Behluli – Sa i përket mjeteve, ka mjete nga vija e subvencioneve nga Drejtoria e shërbimeve publike.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 8 vota abstenim morën Vendim për aprovimin e kërkesës së Ndërmarrjes Publike Lokale “Kastrioti” SH.A. për ndarjen e mjeteve në shumën prej 50,000.00 €, (pesëdhjetë mijë euro) për blerjen e pajisjeve të nevojshme për operim në terren.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për dhënien në debat publik të Draft Rregulloreve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar jemi për atë që kjo Draft Rregullore të dalë në debat publik dhe pas kthimit nga debati publik e japim kontributin tonë. Ne edhe pse jemi anëtarë të Kuvendit kemi të drejtë me marrë pjesë në debate publike, prandaj i lus anëtarët e Kuvendit që të marrin pjesë sepse janë më shumë të njoftuar dhe pajisur, pastaj në Kuvend e debatojmë.

Sami Ahmeti – Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e thamë se është njëra prej Rregulloreve më të rëndësishme, që delë prej Ligjit për zyrtarët publik dhe personalisht duke qenë se jam i fushës unë do të mundohem me dhënë kontributin tim në këtë fushë që secilit punëtorë mos të i merret e drejta sepse pikërisht këtu është ai triku. Është një defekt procedural nëse, dikush kërkon prej MAPL-së, mundet me na kthye se materiali i debatit publik përveç kërkesës anëtarëve të Kuvendit, nuk iu ka shkue. Neve, na ka ardhë si KPF, por anëtarëve tjerë nuk iu ka shkue. Për mua nuk është problem, edhe kolegët tjerë i pyeta se mos ka ndodhë vetëm te unë se materiali kur ka ardhë ka ardhë vetëm kërkesa për dhënien në debat publik.

Kryesuesja – Rregullorja ka ardhë në Komitet, por paska munguar te anëtarët e Kuvendit dhe nëse, ju pajtoheni posa ta kryejmë mbledhjen ne do të ua dërgojmë Draft Rregulloren.

Sami Ahmeti – Unë jam dakord që mos të shtyhet edhe një muaj sepse është dokument i rëndësishëm. **Ajet**

Berisha – E tha parafolësi fatkeqësisht asnjë material dhe për këtë arsye isha i befusuar, ju po thoni me

dhënë në debat publik, por ne nuk kemi parë asgjë, cili është ai dokument që po thoni jepet në debat publik. Prandaj, unë abstenoj sepse është vetëm kërkesa dhe asgjë tjetër, Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 14 vota për dhe 5 vota abstenim morën Vendim për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se nuk kemi asnjë kërkesë për shqyrtim.

Pika 6 e rendit të ditës

Labinot Mirena – Unë e kam një kërkesë për Drejtorinë e shërbimeve publike dhe të inspeksionit, që me dalë në parkingjet publike me i inspektue pak sepse ka njerëz që i kanë vendos kampstëpizat dhe i duket vetja që ka shkue ku me ditë kund në ndonjë bjeshkë, e ka zënë hapësirën publike e qytetarët nuk kanë ku me parkue. Po ashtu, ka edhe x vetura tjera të parkuara qe 3,4 javë e kanë shkruar aty shitet dhe ka mbetë ashtu, do të thotë ne si banorë nuk kemi mundësi për parking. Është mirë me vendosë ndonjë rampë që të dihet se kush është banorë rezidentë dhe tek e fundit me bë parkingun me pagesë 50 centë në mënyrë simbolike. Në parkingun te sheshi i ke 2 kampstëpiza që njerëzit i kanë vendosë dhe nuk e di se a po dojnë me bë banim aty, apo çfarë. Edhe i kemi automjetet e KEDS-it, që janë 4,5 automjete të parkuara aty dhe banorët nuk po kanë ku me i lënë veturat. Mendoj se është mirë me ua dërgue një ftesë që me i largue prej pronës publike.

Bajram Hashani - Unë kam një pyetje, kërkesë, sqarim rreth pagesës së Komitetit per Politikë dhe Financa dhe Komitetit për komunitete. Sot e pashë në listë që ish e përgjysmuar, nuk e di cila po mungon dhe unë nuk kam pasë mungesa, prandaj kërkoj prej Kuvendit me na dhënë sqarime për çfarë është kjo ndalesë. Unë nuk e nënshkruva dhe vërtetë duhet me na sqauë pak këtë çështje.

Kryesuesja – Sqaron se nuk e kemi marrë meditet e mbledhjes sepse mbledhja është shtye dhe është mbajtë në këtë muaj, kështu që pagat me nënshkrime kanë shkue para se të mbahet mbledhja. Ne nuk kemi mund me i dërgue pagesat pa u mbajtë mbledhja sepse nuk kemi ditë kush merrë pjesë në mbledhje, por në muajin që vjen e merrë retroaktiv pagesën edhe për këtë muaj.

Valbonë Beka – Unë e kam një propozim te mbeturinat e vendosura afër sheshit, kishte me qenë mirë me i vendosë disa kamera me i përcjellë se kush po hedhë mbeturinat sepse tash fillon me u nxehë moti e aty bëhet tmerr. Ne që jetojmë afër aty, pastaj nuk mund të rrimë prej erës e kundërmimit që bëhet aty. Propozoj të vendosen kamerat dhe të denohen qytetarët që e bëjnë gjithë atë tollovi aty.

Sami Ahmeti – Pjesërisht më heret e tha z.Ajet për çështjen e ndërtimit të ambullantës së QKMF-së, që ka mbetë dhe kishim pasë dëshirë që në seancën e ardhshme të na jepet pak një orientim deri ku ka shkue, kur kryhet, pse po zvarritet e plot çështje tjera. Edhe kur jemi te kjo fushë së paku 3 persona të stafit shëndetësor më kanë thënë se po kanë probleme me meditet e tyre, fjala është për orët e natës e shtunë dhe e dielë që i ka Komuna si obligim. Unë nuk e njohë këtë farë fushe mirë, por kishim pasë dëshirë jo sot nuk ka problem, por në seancën e ardhshme me na informue dikush.

Kryesuesja – Ne do të ia përcjellim pyetjen drejtoreshës.

Valon Svirca – Unë e kam një kërkesë te objekti afër shkollës tonë në Mazgit, pothuajse ka përfundue pjesa për hapjes e odës për të pame kanë mbetë vetëm edhe moblijet nëse, kishte me mund Komuna me intervenue, ose me detyrue fshatin me rregullue. Pothuajse, 80-90 % të punëve kanë përfunduar vetëm edhe mobiljet, apo ç+ka shkojnë ato përcjellëse kanë mbetë.

Arben Berisha – Unë e kam një kërkesë për Kuvendin, nëse nuk gaboj para 2 seancave e kemi pasë një kërkesë nga ujësjellësi për çështjen e marrjes së pronës në shfrytëzim dhe na u ka kthye nga Ministria. Tash, e kemi një kërkesë prapë nga ujësjellësi KUR Prishtina është e adresuar në formën e duhur, por ne pa

titullar prone nuk mundemi me lënë. Ne e kemi nxjerrë një vendim për largim nga aty, por e kemi pezullue për shkak të kërkesës së dytë që na ka ardhë. Në seancën e radhës do ta bëjmë një propozim vendim prapë dhe nëse, ju e keni vullnetin me votue për me ia dhënë në shfrytëzim KUR Prishtunës, objektin që e kemi të ndërtuar që ka qenë më heret.

Ajet Berisha – Është aspekt procedural, e para duhet me ardhë vendimi që e ka nxjerrë ky Kuvend Që nuk ia japim, që me anulue atë vendim.


Shaip Paloja – E kemi anulue atë vendim.

Ajet Berisha - Nuk më kujtohet që e kemi anulue. Një ditë kur e ngrita si çështje z.Shaip me dikend këtu më tha jo nuk e kemi marrë atë vendim e unë thashë që e kemi marrë e kemi anulue dhe nuk ia japim më


Kryesuesja – E kemi shfuqizue atë vendim sepse ka ardhë nga Ministria.

Mbledhja përfundoi në ora 11:56'

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi

